

Sindikata paralajmëron veprime po qe se riorganizimi prek interesat e shërbyesve civilë

Faqe 2



Vuqiç: Serbia sivjet do të përballet me ultimatum rreth njohjes së Kosovës

Faqe 3



Dhomat e Specializuara të Kosovës: Komunikimi i drejtësisë ndërkombëtare

Shkruan:
Ekaterina Trendafilova

Faqe 9



Sandersi u prin demokratëve kundrejt presidentit Trump



Faqe 6

e hënë • 24 shkurt 2020

Numri 8115 • Çmimi 0,50 €

KOHA DITORE

www.koha.net



INTERVISTË E ANALISTIT GJERMAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, BODO WEBER

Weber: BE-ja drejt politikës Mogherini 2.0

“Bazuar në ‘filozofinë’ aktuale të dukshme të Brukselit, emërimi i Lajçakut do ta çonte BE-në drejt një politike Mogherini 2.0. Në rastin më të mirë, pra, pa ringjalljen e ideve për ndarjen ose shkëmbimin e territoreve, politika e tillë do ta fuste BE-në drejt kurthit – ‘çfarë t’i jepet Serbisë’”, ka thënë për “Kohën Ditore” Bodo Weber, analist në Këshillin për Politikë dhe Demokratizim në Berlin dhe Bruksel

Fitim Gashi

PRISHTINË, 23 SHKURT – Miroslav Lajçak është njeriu i gabuar për ta udhëhequr dialogun Kosovë-Serbi në emër të Brukselit, për shumë arsye, ka thënë Bodo Weber, analist në Këshillin për Politikë dhe Demokratizim në Berlin dhe Bruksel. Në pritje të zyrtarizimit të diplomatit slovak si emisar i BE-së për negociatat e ardhshme, Weber ka listuar tri shkaqet që, sipas tij, e bëjnë të padenjë Lajçakun për këtë detyrë. Përveç faktit se slovaku vjen nga një shtet që nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, Weber thotë se atij i faturohet edhe një “histori dështimesh politike në Ballkan”.

Sipas analistit gjerman, emërimi i Lajçakut do ta çonte BE-në drejt një politike Mogherini 2.0. Të rrezikshëm e konsideron edhe kërkesën e slovakut për portofol shumë më të gjerë sesa negociatat ndërmjet Beogradit e Prishtinës.

Në një intervistë dhënë “Kohës Ditore”, Weber ka komentuar edhe për rolin e SHBA-së në procesin e dialogut me emërimin e një emisari të posaçëm. Sipas tij, angazhimi i Richard Grenellit në tri detyra, të njëjtën kohë, më shumë do t’i shërbejë atij për promovimin e vetvetes.

Sa i përket taksës ndaj mallrave me origjinë nga Serbia, Weber ka thënë se Qeveria e re do të duhej t’i vendoste kushtet për heqjen e saj, në kontekst të kërkesës së partnerëve evropianë për ta përcaktuar

një kornizë negociatash, e cila sqaron se cili do të jetë rezultati dhe qëllimi përfundimtar i një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse.

Lajçak i papërshtatshëm për ndërmjetës

KD: z. Weber, së fundi keni publikuar një opinion në “Euobserver” me bashkautorë Toby Vogel, në pritje të emërimit të ministrit të Jashtëm, Miroslav Lajçak, emisar i BE-së për dialogun Kosovë-Serbi? Pse mendoni se diplomati slovak nuk është zgjidhje e duhur?

Weber: Javën e kaluar përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, la të nënkuptohet se me udhëheqjen e dialogut, do të thotë negociatat Kosovë-Serbi, roli i BE-së nuk është të marrë anë. Epo, ajo që e mundësoi dialogun në fillim kishte të bënte pikërisht me anime – qasja e Evropës dhe parimet e Perëndimit ishin se “koha e ndryshimeve të kufijve ka mbaruar”, “eliminimi i strukturave paralele serbe”, bazuar në vlerat liberale demokratike dhe në mësimet e marra nga luftërat ballkanike të viteve 1990. Por paraardhësja e tij, Mogherini, dhe ekipi i saj ndryshuan qasjen nga parimet evropiane në atë të dy presidentëve (Thaçi e Vuçiç v.j.), kur deklaruan se roli i tyre nuk është t’i mbrojnë “vijat e kuqe”, do të thotë parimet.

vijon në faqen e tretë



Shqipëria është në ethet e përhapjes së koronavirusit nga shteti fqinj, Italia, që është shndërruar në vatrë të koronavirusit në Evropë, me tri viktima dhe 132 persona të infektuar. Rreziku më i madh i kërcënohet Shqipërisë nga afërsia fqinjësore me Italinë, si dhe nga emigrantët shqiptarë atje, të cilët kanë filluar të kthehen në atdhe nga frika e infektimit me virusin vdekjeprurës. Burime nga Porti i Brindisit kanë bërë të ditur se në mesnatë, duke u gdhirë e diel, janë vënë re radhë të gjata të shqiptarëve në Brindisi, të cilët po niseshin me traget drejt Vlorës. Zyrtarë të shtetit shqiptar kanë siguruar qytetarët se Shqipëria ka marrë masa dhe se aktualisht nuk ka asnjë person të prekur me virusin vdekjeprurës. Ndërkohë në Korenë e Jugut është shpallur gjendje e jashtëzakonshme shëndetësore shkaku i koronavirusit, ndërsa në Kinë autoritetet kanë konfirmuar 77 mijë të infektuar

MINISTRES SË ARSIMIT I KËRKOHET QË TA KTHEJË NË PIKËN ZERO SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË KËTË INSTITUCION

Stafi civil kërkon shfuqizimin e Rregullores për organizimin e vendeve të punës në MASHTI

Edona Kutleshli

PRISHTINË, 23 SHKURT - Shfuqizim të menjëhershëm të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Arsimit, po i kërkojnë ministres, Hykmete Bajrami drejtorë të departamenteve e divizioneve të MASHTI-t, të larguar nga pozitat e tyre në kohën e ish-ministrit, Shyqiri Bytyqi. Kjo pasi po e konsiderojnë se ky dokument ka qenë i jashtëligjshëm dhe brenda një viti e gjysmë ka shkaktuar kaos në MASHTI.

Në tetor të vitit 2018, me pretendimin se po sjellin reforma,

MASHTI duke u thirrur në këtë rregullore i largoi 32 drejtorë e udhëheqës divizioneesh. Ish-ministri Bytyqi, në vend të të larguarve kishte emëruar persona të tjerë. Për shkak se disa nga të larguarit nga pozitat e tyre bënë ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil (KPMShCK) dhe ngritën padi ndaj Qeverisë dhe MASHTI-t, procesi i organizimit të vendeve të punës u bllokua. Që nga ajo kohë e deri më sot, Ministria ishte detyruar t’i paguajë me pagë të njëjtë edhe të larguarit, edhe të emëruarit në ato pozita duke shpenzuar mjete të konsiderueshme financiare.

Dy nga drejtorët e larguar i kanë thënë “Kohës” se për hartimin dhe miratimin e Rregullores nuk ishin respektuar procedurat e nevojshme ligjore. Për këtë vlerësojnë se është i domosdoshëm shfuqizimi i këtij dokumenti.

Ferit Idrizi, i cili prej vitit 2013 ishte drejtor i departamentit të Integritetit në MASHTI, ka deklaruar se ministria Bajrami duhet ta dërgojë këtë rregullore në Qeveri dhe ta kthejë në funksion të vjetër.

“Shkelja e parë është se rregullorja është bërë pa ndonjë komision, por vetëm nga kabineti i ish-ministrit. Shkelja tjetër është se kjo rregullore nuk është miratuar

në Ministrinë e Administratës Publike, por ka shkuar drejt në Qeveri e sipas legjislacionit është dashur të miratohet fillimisht në MAP. Bytyqi në emër të reformave ka bërë spastrime të kuadrove për të sjellë militantë të subjektit të tij”, ka thënë ai.

Sipas tij, ka plot argumente që Bytyqi ka bërë shumë shkelje dhe nuk i ka përfillur procedurat për këto reforma. Edhe në rastin e tij ka thënë se u largua jashtëligjshëm.

“Bytyqi nuk ka pasur të drejtë as të angazhojë e lëre më t’i lëshojë një personi tjetër aktemërim.

vijon në faqen e dytë

Kosova bën një hap të madh në parakualifikimet për Botërorin 2023



Kombëtarja e Kosovës në basketboll ka bërë një hap të madh para, drejt kalimit me sukses të raundit të parë të parakualifikimeve për Botërorin e vitit 2023. Kosova të dielën mbrëma, në palestrën “d’Coque” të Kirchbergut, mposhti Luksemburgun me katër pikë dallim, 80:84. Ishte kjo ndeshje e Grupit B parakualifikues...

Faqet 24

INTERVISTË E ANALISTIT GJERMAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, BODO WEBER

Weber: BE-ja drejt politikës Mogherini 2.0

“Bazuar në ‘filozofinë’ aktuale të dukshme të Brukselit, emërimi i Lajçakut do ta çonte BE-në drejt një politike Mogherini 2.0. Në rastin më të mirë, pra, pa ringjalljen e ideve për ndarjen ose shkëmbimin e territoreve, politika e tillë do ta fuste BE-në drejt kurthit – ‘çfarë t’i jepet Serbisë’”, ka thënë për “Kohën Ditore” Bodo Weber, analist në Këshillin për Politikë dhe Demokratizim në Berlin dhe Bruksel

vijon nga ballina

Dhe, me këtë pothuajse i çuan rajonin dhe Evropën drejt katastrofës, me aventurën e tyre të shkëmbimit të territoreve. Kam frikë se z. Borrell, i cili ka paralajmëruar se do ta rivendosë besueshmërinë e Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor të dëmtuar nga paraardhësja e tij, do të hyjë në këpucët e zonjës Mogherini, pa qenë i vetëdijshëm për këtë.

Në mënyrë që Bashkimi Evropian t’i rivendosë parimet serioze të negociatave për një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme midis Kosovës dhe Serbisë, zotëri Borell dhe BE-ja së pari duhet të jenë të vetëdijshëm dhe t’i definojnë politikat evropiane me të cilat do të udhëhiqet dialogu, si dhe të rivendoset roli udhëheqës i Bashkimit Evropian. Më pastaj, mbështetur në këto politika, të emërohet një emisar/përfaqësues special me profilin që i përshtatet kësaj politike. Duket se me identifikimin e z. Lajçak për këtë pozitë, ka ndodhur e kundërta.

KD: Pse vlerësoni se ka ndodhur e kundërta, çka tjetër konsideroni se e bën të papërshtatshëm Lajçakun për këtë pozitë, përveç faktit se ai vjen nga një shtet që nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës?

Weber: Ekzistojnë tri arsye kryesore pse z. Lajçak është personi i gabuar për këtë pozitë.

Së pari, emërimi i dikujt nga një shtet i BE-së që nuk e ka njohur Kosovën, për të udhëhequr negociatat së bashku me zotin Borrell, i cili po ashtu, vjen nga një vend jonjohës, “de fakto” përfaqëson animin dramatik tek njëra palë. Së dyti, ai vjen me një bagazh, një histori të dështimit politik në Ballkan gjatë kohës kur shërbeu si përfaqësues i lartë i BE-së në Bosnjë-Hercegovinë. Ai hyri në një konflikt politik me të fortin Milorad Dodik, si pjesë e një politike të keqprojektuar nga BE-ja, duke përfunduar me një tërheqje fyese. Kjo ngjall frikën se Lajçak si përfaqësues i BE-së për gjithë rajonin, i cili tradicionalisht është dëshmuar i dobët në raport me Dodikun, mund të jetë i prirë të tregtojë diçka për Bosnjë-Hercegovinën për llogari të një marrëveshjeje Kosovë-Serbi. E fundit, dhe ndoshta më shqetësuesja, është se ai ka një historik të vendosjes së interesave personale karrieriste para qëllimeve politike. Kjo duket se konfirmohet nga fakti që me gjasë ai ka kërkuar një portofol më të gjerë sesa negociatat Kosovë-Serbi, do të thotë Bosnjë-Hercegovinën dhe rajonin, kur dihet mirëfilli se të merrresh me



Foto: Driton Paçarada

dialogun Kosovë-Serbi në vetvete është një punë me orar të plotë. Dhe kjo ishte pikërisht ajo që e shtyu ekipin e Mogherinit të aplikonte qasjen- se konceptet etnike-territoriale nuk janë të mira për Kosovën, Serbinë ose BE-në, por karriera personale që udhëhiqet sipas interesit, “çfarëdo marrëveshjeje është një marrëveshje e mirë”.

Për ta përmbledhur, emërimi e zotit Lajçak, bazuar në ‘filozofinë’ aktuale të dukshme të Brukselit, do ta çonte BE-në drejt një politike Mogherini 2.0. Në rastin më të mirë, do të thotë, pa ringjalljen e ideve për ndarjen ose shkëmbimin e territoreve, një politikë e tillë do ta çonte BE-në drejt kurthit – ‘çfarë t’i jepet Serbisë’”? Kurthi politik i Beogradit, duke e larguar Prishtinën larg tryezës së negociatave, do të bëjë që negociatat të dështojnë qysh në rinisje.

KD: Cila do të duhej të ishte qasja e Qeverisë së Kosovës në raport me këto zhvillime?

Weber: “Qeveria e re e shpresës”, që nga dita e parë në zyre po ballafaqohet me një sprovë ekzistenciale, të krahasueshme me atë që u mor Qeveria e mëparshme para një viti, kur u përball me presionin e administratës së Trumpit për ta hequr tarifën, në mënyrë që dy presidentët në “Kopshtin e luleve” në Washington ta nënshkruajnë marrëveshjen për shkëmbim territoresh.

Kur nisi “faza e re” e re në dialog, përkatësisht negociatat për një mar-

rëveshje përfundimtare në verën e vitit 2017, presidenti Thaçi para tavolinës së tij në Bruksel pati një përkthim në anglisht të marrëveshjes gjermano-gjermane të vitit 1972. Kjo do të thotë se ai ishte çarmatosur në mënyrë të njëanshme për çështjen e njohjes së Kosovës nga Serbia, para se negociatat e vërteta të fillonin, për arsyt që ne tani i dimë shumë mirë. Qeverisë së re i duhet të marrë një vendim të pakëndshëm ditëve në vijim- nëse do t’u tregojë kryeqyteteve evropiane se nuk pranon të ulet në tryezën e bisedimeve me dy negociatorë që nuk e njohin Kosovën, ose të tërhiqet. Nëse ndodh kjo e fundit, megjithëse me një motiv krejtësisht të ndryshëm, do të çarmatosej pozicioni negociues i Kosovës përpara negociatave të ardhshme, ashtu siç bëri Thaçi para tre vjetëve.

KD: Përmendët kërkesën e SHBA-së për heqjen e taksës prej 100 për qind për mallrat nga Serbia. Qeveria e re dhe kryeministri Kurti kanë premtuar heqjen e taksës, por pasi të vendoset reciprociteti politik, ekonomik dhe tregtar me Serbinë. E shihni këtë si lëvizje pozitive?

Weber: Varet. Përpjekjet e Gjermanisë dhe të Francës për të ndaluar aventurën e Mogherinit për shkëmbim të territoreve verën e kaluar, mundësojnë rivendosjen e negociatave duke përcaktuar një kornizë bisedimesh e cila do t’i mundësonte Prishtinës ta pezullonte tarifën, e cila u vu krejtësisht në mënyrë jo të drejtë nga kërkesa e kryeministrit

Haradinaj për ta vendosur njohjen e Kosovës nga Serbia si parakusht për negociatat. Kështu ai e dobësoi në mënyrë të panevojshme pozicionin negociues të Kosovës dhe e liroi Beogradin nga presioni. Qeveria e re do të bënte mirë nëse i vendos kushtet e saj për heqjen e tarifës, në kontekst të kërkesës së partnerëve evropianë për të përcaktuar një kornizë negociatash, e cila sqaron se cilët do të jenë rezultatit dhe qëllimi përfundimtar i një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse. Dhe në atë kontekst duhet të sqarohet konkretisht kuptimi i “reciprocitetit”.

KD: Në anën tjetër, Shtetet e Bashkuara tashmë kanë emëruar një të dërguar special për dialogun- Richard Grenellin, i cili të njëjtën kohë do të mbajë postin e ambasadorit në Gjermani dhe të drejtorit të Inteligjencës Amerikane. Ai së fundi ndërmjetësoi arritjen e disa marrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë, përfshirë dy të fundit në Gjermani. Si e shihni rolin e tij dhe të ShBA-së në këtë proces?

Weber: Performanca e tij si emisar i SHBA-së në dialog me gjysmë orari, si ambasador me gjysmë orari dhe tani gjysmë orari edhe shef i Inteligjencës, do të mund të karakterizohej me vënie pengesash dhe promovim të vetvetes. Kjo e fundit, kemi parë se ka qenë shumë më efektive. Megjithatë, qasja ekonomiste, transaksionale e tipit “çfarëdo marrëveshjeje është marrëveshje e mirë”, është qasje humbëse dhe çon drejt dështimit- ashtu siç dëshmoi historia e dialogut politik, ose episodi i publikuar së fundi për “Planin e paqes” në Palestinë.

KD: Cilat janë dallimet ndërmjet SHBA-së dhe Bashkimit Evropian sa i përket dialogut dhe sa do të reflektohen ato në marrëveshjen e mundshme finale?

Weber: Nëse edhe Bashkimi Evropian emëron një emisar/përfaqësues special për të cilin “çdo marrëveshje është marrëveshje e mirë”, kam frikë se do të shohim një sinergji të përsosur në prishjen e negociatave ende pa filluar.

KD: Çfarë kompromisesh mund t’u kërkojnë palëve në negociatat e ardhshme?

Weber: Kjo është diçka, për të cilën vendimmarrësit kryesorë në

Në një intervistë dhënë “Kohës Ditore”, Weber ka komentuar edhe për rolin e SHBA-së në procesin e dialogut me emërimin e një emisari të posaçëm. Sipas tij, angazhimi i Richard Grenellit në tri detyra, të njëjtën kohë, më shumë do t’i shërbejë atij për promovimin e vetvetes

BE duhet të jenë përsëri të vëmendshëm. Dialogu politik kurrë nuk ka qenë e as nuk ka të bëjë me kompromise për statusin. Kjo ishte e mundur për Serbinë, ndoshta deri në negociatat e Trojkës (negociatat e Vjenës për statusin final të Kosovës v.j). Serbia e humbi atë shans sepse për politikën serbe Kosova për tri dekada kishte shërbyer gjithnjë si mjet, jo si qëllim në vetvete. Dhe, për shkak të kësaj, elita politike në Serbi nuk ishte kurrë në gjendje të artikulonte politikën sipas së cilës Kosova duhej të mbetej pjesë e Serbisë, dhe në të njëjtën kohë ta pranonte popullsinë shumicë shqiptare si qytetarë të saj. Prej shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, çështja është që Serbia ta pranojë realitetin se e ka humbur dhe është larguar nga Kosova. Dialogu fillestar politik mundësoi përparim historik, sepse bazohej në kushte që BE-ja i kishte vënë Serbisë në rrugën drejt anëtarësimit, për njohjen e realitetit në Kosovë. Heqja e atyre “vijave të kuqe” dhe përfshirja nga ekipi i Mogherinit të hilesë së Vuçiqit që tani thotë “çfarë do t’i jepni Serbisë?”, është edhe pasojë e krizës së Perëndimit në dy skajet e Atlantikut, dhe ajo që shkatërroi dialogun politik që nga viti 2015.

KD: Cili është zhvillimi që duhet t’i paraprijë normalizimit të marrëdhënieve dhe korniza dialoguese që duhet vendosur?

Weber: Zhvendosja drejt një rivlerësimi serioz të negociatave do të thotë të riafirmosh kornizën, arsyetimin dhe qëllimet e dialogut të vërtetë. Dhe vetëm atëherë, dhe brenda këtij kuadri do të jetë e domosdoshme të negociosh kompromise për çështje konkrete. Pra, jo për statusin, por për çështje të hapura mes dy palëve. Që të vendosen paqja e qëndrueshme dhe marrëdhëniet bilaterale normale midis Kosovës dhe Serbisë, Serbia duhet të çlirohet nga “Serbia hyjnore”, madje edhe më shumë serbët e Kosovës, të cilët janë kthyer nga objekt kryesor i dialogut, në dëmin kryesor kolateral. Po ashtu, duhet të ndodhë zhblllokimi i situatës drejt një transformimi të qëndrueshëm demokratik me prosperitet ekonomik të të dyja shoqërive, për t’u bërë pjesë e familjes së demokracive evropiane.

© KOHA Ditore

Vuçiq: Serbia sivjet do të përballet me ultimatum rreth njohjes së Kosovës

Serbia sivjet do të përballet me ultimatum rreth Kosovës, ka thënë të dielën, në një emision të mëngjesit, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Duke folur rreth Kosovës, presidenti serb ka thënë se “shtetit tonë me siguri do t’i vihet ultimatum”.

“Është e sigurt se do të na vihet ultimatum. Do të na japin garanci për anëtarësim në BE dhe ta njohim Kosovën. E di edhe se kush do të jetë i dërguar për negociata

me Prishtinën, por tani për tani nuk mund ta them. Dhe, do të na ofrojnë status special për serbët në rajonet e caktuara. E çfarë atëherë? Unë do ta pyes popullin”, ka thënë Vuçiq.

Në pyetjen e gazetares së çfarë do të bëjë, nëse ai përballet me ultimatum, Vuçiqi ka thënë: “Do ta shihni”, raporton “Blic”, transmeton Koha.net.

Presidenti i Serbisë në këtë mënyrë ka komentuar deklaratat

e akademikut serb, Dushko Kovaçević, në një intervistë për gazetën “Blic”. Rreth deklarimeve të tij se Serbia pritet ta zgjidhë çështjen e Serbisë dhe se BE-ja, SHBA-ja dhe Gjermania kanë zgjedhur ta zgjidhin atë, presidenti serb ka thënë se shumëkush ka thënë se ai u ka premtuar të tjerëve pavarësinë e Kosovës, por se nuk është ashtu. “Askënd nuk e kam gënjer, nuk jam gënjeshtar”, ka thënë ai.